



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 23/6 Prot.

Tiranë më, 21/01/2022

VENDIM

Nr. 5, datë 21.01.2022

“Për miratimin e kriterëve për disbursimin e vlerës së përcaktuar për kërkimin shkencor”

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe bazuar në Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në mbledhjen e tij të radhës Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Fondet do të jepen në bazë të Projekt-propozimeve të sjella nga stafi akademik, ku duhet përcaktuar qartazi lidhja midis aktivitetit dhe produktit shkencor.
2. Projekt propozimet duhet të kenë të përcaktuar qartë, qëllimin, objektin, ndarjen e detajuar në zëra dhe shumën e buxhetit që kërkohet.
3. Përcaktimin qartë të mënyrës së prokurimit të fondeve për çdo projekt të miratuar.
4. Ngritjen e një komisioni të koordinimit të projekteve kërkimore shkencore që do të bëjë vlerësimin e projekt propozimeve.
5. Krijimin e një rregulloreje për kriteret e vlerësimit dhe miratimit të projekt-propozimeve, rregullore e cila do t'i kalohej bordit për miratim.
6. Ngarkohet Zyra e Financës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

EMIS CERAVA

